

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **328-26-3892-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Sigurimi i auto përgjegjësisë për automjetet e KGJK-së dhe Gjykatave**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>KOMPANIA E SIGURIMEVE " PRISIG " SH.A.</b>
NUI	<b>601173371</b>
Adresa	<b>Rr.Eduard Lir, Ob.2-Lagj.Arbëria</b>
Vendi	<b>PRISHTINË</b>
Kodi postar	<b>10000</b>
Numri Telefonit	<b>038 221 000</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Besarb Blakaj</b>
Adresa elektronike	<b>tenders@prisig-ks.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>06.07.2026</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

#### **Sigurimi i auto përgjegjësisë për automjetet e KGJK-së dhe Gjykatave**

Ne Kompania e Sigurimeve Prisig SH.A, kemi marr pjese ne aktivitetin e prokurimit me titull: **Sigurimi i auto përgjegjësisë për automjetet e KGJK-së dhe Gjykatave** si dhe me nr. te prokurimit: **328-26-3892-2-2-1**, pas njoftimit per vendim te AK, ku ne **KS. PRISIG SH.A** jemi shpallur ofertues te eliminuar padrejtesisht nga aktiviteti I ketij prokurimit ndersa OE Sava eshte shpallur fitues. Operatori Ekonomik PRISIG SH.A., në afatin ligjor të përcaktuar me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, paraqet këtë ankesë kundër Vendimit për Dhënie të Kontratës, për shkak se vendimi është marrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe dokumentacionin e tenderit. Pas pranimit të Njoftimit per Vendim nga AK,ne kemi kerkuar qasje ne dokumentet e OE Sava sh.a ku pas shqyrtimit te dokumentacionit kemi verejtur disa mangesi ne dosjen e tyre. Me daten 30.06.2026 kemi paraqitur kerkesa per rishqyrtim tek autoriteti kontraktues, ndersa me daten 01.07.2026 kemi pranuar pergjigjen e autoritetit me refuzim ndaj kerkeses sone per rishqyrtim. Pas ketij vendimi te autoritetit per refuzim te kerkeses sone, jemi te obliguar te paraqesim ankesen tone prane OSHP-se. Edhe pse ankesa jone ne kerkesen per rishqyrtim lidhet me shkeljen e 12 neneve dhe pikave te LPP dhe RR/PPP, autoriteti ka zgjedhur menyre me te leht per te refuzuar ankesen tone, duke thene qe eshte dashur te kerkojme kerkojme sqarime shtese. Autoriteti kontraktues po e zhvendos barren e përgjegjësisë tek ne si OE duke thënë që : “Nëse OE kanë pasur paqartësi lidhur me klasifikimin e automjetit ose mënyrën e aplikimit të tarifave të BQK-së, ai ka pasur mundësinë dhe obligimin që, gjatë periudhës së publikim të dosjes së tenderit, të kërkonte sqarime nga Autoriteti Kontraktues-SKGJK”.

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

Jo

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**Njoftimi për kontratë: 01.06.2026**

**Takimi për hapjen e tenderëve: 26.06.2026**

**Procesverbali i hapjes së tenderëve : 26.06.2026**

**Njoftimi për vendimin e AK : 29.06.2026**

**Kërkesë për rishqyrtim: 30.06.2026**

**Pergjigje e kërkesës për rishqyrtim: 01.07.2026**

## **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Shkelje e nenit 1 të LPP-së (Qëllimi)

Shkelje e nenit 6 të LPP-së (Ekzaminimi dhe Efikasiteti)

Shkelje e nenit 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi)

Shkelje e nenit 28 të LPP-së (Specifikimet teknike)

Shkelje e nenit 19.1, 19.4, 19.11 të RR/PPP (Specifikimet teknike)

Shkelje e nenit 59 të LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Shkelje e nenit 40.2, 40.6, 40.12 të RR/PPP (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Shkelje e nenit 60 të LPP-së (Kriteret për Dhënien e Kontratës).

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Ne Kompania e Sigurimeve Prisig SH.A, kemi marr pjese ne aktivitetin e prokurimit me titull: Sigurimi i auto përgjegjësishë për automjetet e KGJK-së dhe Gjykatave si dhe me nr. te prokurimit: 328-26-3892-2-2-1, pas njoftimit per vendim te AK, ku ne KS. PRISIG SH.A jemi shpallur ofertues te eliminuar padrejtesisht nga aktiviteti I ketij prokurimit ndersa OE Sava eshte shpallur fitues. Operatori Ekonomik PRISIG SH.A., në afatin ligjor të përcaktuar me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, paraqet këtë ankesë kundër Vendimit për Dhënie të Kontratës, për shkak se vendimi është marrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe dokumentacionin e tenderit. Pas pranimit te Njoftimit per Vendim nga AK,ne kemi kerkuar qasje ne dokumentet e OE Sava sh.a ku pas shqyrtimit te dokumentacionit kemi verejtur disa mangesi ne dosjen e tyre. Me daten 30.06.2026 kemi paraqitur kerkese per rishqyrtim tek autoriteti kontraktues, ndersa me daten 01.07.2026 kemi pranuar pergjigjen e autoritetit me refuzim ndaj kerkeses sone per rishqyrtim. Pas ketij vendimi te autoritetit per refuzim te kerkeses sone, jemi te obliguar te paraqesim ankesen tone prane OSHP-se. Edhe pse ankesa jone ne kerkesen per rishqyrtim lidhet me shkeljen e 12 neneve dhe pikave te LPP dhe RR/PPP, autoriteti ka zgjedhur menyre me te leht per te refuzuar ankesen tone, duke thene qe eshte dashur te kerkojme kerkojme sqarime shtese. Autoriteti kontraktues po e zhvendos barren e përgjegjësishë tek ne si OE duke thënë që : “Nëse OE kanë pasur paqartësi lidhur me klasifikimin e automjetit ose mënyrën e aplikimit të tarifave të BQK-së, ai ka pasur mundësinë dhe obligimin që, gjatë periudhës së publikim të dosjes së tenderit, të kërkonte sqarime nga Autoriteti Kontraktues-SKGJK”. Ne nuk kemi pasur diqka të paqartë bazuar ne Listen e Cmimeve, si shembull mund te merret edhe tabela e mëposhtme:

Nr.	Lloji i Automjetit	Motorri cm <sup>3</sup>	Viti i Prodhimit	Sasia Indikateve Automjeteve për dy (2) vite	Cmimi Për njësi me TVSH
-----	--------------------	-------------------------	------------------	--	-------------------------

Ky lloji I tabelës është plotësisht I qartë dhe nuk kërkon sqarime apo informata shtetse që është e cekur mjaft mire Motorri Cm3, siq e ka bërë kërkesën vet AK.

Ndërsa nese kishte qenë lloji I tabelës si mëposhtë:

Nr.	Lloji i Automjetit	Motorri cm <sup>3</sup> /TON	Viti i Prodhimit	Sasia Indikateve Automjeteve për dy (2) vite	Cmimi Për njësi me TVSH
-----	--------------------	------------------------------	------------------	--	-------------------------

Atëherë ky lloji I shënimeve, do të na obligonte që mbase të kërkonim sqarime shtetse duke I kërkuar që të njoftojë se cilat automjete janë që I përkasin kategorisë Cm3 me Ton.

Ndërsa tabela optimale do të duhej të ishte:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i Automjetit</b>	<b>Motorri cm<sup>3</sup>/TON</b>	<b>Viti i Prodhimit</b>	<b>Sasia Indikateve Automjeteve për dy (2) vite</b>	<b>Cmimi Për një me TVSI</b>
1	Nissan Pathfinder	2500cm3	2008	18	
2	Nissan Patrol	3000 cm3	2008	22	
3	Renault Megan	1600 cm3	2006	2	
4	Passat	2000 cm3	2008	2	
5	Kamionet Kia	1.46Ton	2003	2	
6	Land Rover Freelander	2500 cm3	2009	2	
7	Skoda Octavia	1900 cm3	2009	28	
8	Mercedes Benz	2000 cm3	2009	4	
9	Golf 4	1900 cm3	2003	16	
10	Ford Mondeo	2000 cm3	2012	4	
11	Ford Fiesta	1600 cm3	2012	14	
12	Mercedes Benz AMG E43	3000 cm3	2019	2	
13	Skoda Yeti	2000 cm3	2014	6	
14	Peugeot 208	1500 cm3	2024	38	
15	Skoda Superb	2000 cm3	2025	26	

Në rast se tabela do të ishte I këtij formati, atëherë nuk do të kishim ardhur deri në këtë pozicion duke bërë ankesë, sepse cdo gjë do të ishte e qartë. Specifikimet teknike për secilin automjet do të ishin të rregulluara duke na e bërë edhe neve me te lehtë vendosjen e cmimeve sipas shënimeve teknike, kategorisë së veturës dhe tarifave të BQK-së.

Gjendja Faktike:

Në vendimin e Autoritetit Kontraktues është konstatuar se oferta e Operatorit Ekonomik PRISIG SH.A. është shpallur e papërgjegjshme me arsyetimin se:

*"Komisioni i vlerësimit ka konstatuar se operatori ekonomik nuk i është përmbajtur kritereve të përshkrimi i çmimeve të BQK-së. Kamioni KIA 2500 D/C 1.46 Ton hyn në Grupin Tarifor II – Ton Automjete me çmim 240.72 €, e jo në Grupin Tarifor I, siç është llogaritur nga operatori ekonomik me çmim 268.96 €."*

Ky arsyetim është tërësisht i pabazuar si në aspektin faktik ashtu edhe në atë juridik. Autoriteti Kontraktues në Listën e Çmimeve dhe në Specifikimet Teknike nuk ka përcaktuar askund se automjeti KIA 2500 D/C 1.46 Ton duhet të trajtohet sipas Grupit Tarifor II – Ton Automjete. Përkundrazi, automjeti është përshkruar vetëm sipas karakteristikave teknike të publikuara nga vetë Autoriteti Kontraktues, pa asnjë shënim apo referencë se për efekt të ofertimit duhet të aplikohet grupi tarifor sipas tonazhit. Ne, OE PRISIG SH.A. kemi hartuar ofertën duke iu përmbajtur në mënyrë rigorozë dokumentacionit të tenderit, duke iu përmbajtur në mënyrë të plotë të dhënave dhe specifikimeve teknike të publikuara ashtu siç është publikuar nga Autoriteti Kontraktues. Në mungesë të një udhëzimi të qartë se automjeti duhet të trajtohet sipas Grupit Tarifor II, ne nuk kishim asnjë bazë ligjore që të devijonim nga të dhënat e paraqitura në dokumentacion. Është e papranueshme që pas hapjes së ofertave Autoriteti Kontraktues të mbështetet në një interpretim ose klasifikim që nuk është bërë pjesë e dokumentacionit të tenderit dhe, mbi këtë bazë, të eliminojë një operator ekonomik. Ne nuk kemi as të drejtë dhe as obligim të ndryshojmë, korrigjojmë apo interpretojmë ndryshe specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktues. Përkundrazi, çdo operator ekonomik është i detyruar të ofertojë sipas dokumentacionit zyrtar të tenderit.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se automjeti në fjalë duhet të klasifikohet në Grupin Tarifor II sipas tarifave të BQK-së, atëherë ky informacion duhet të ishte përcaktuar qartë dhe pa asnjë paqartësi në dokumentacionin e tenderit, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të ofertonin mbi të njëjtën bazë dhe në kushte të barabarta. Mosparaqitja e këtij informacioni në dokumentacion dhe përdorimi i tij vetëm në fazën e vlerësimit përbën shkelje të parimit të transparencës, të trajtimit të barabartë dhe të sigurisë juridike, të garantuara me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik. Po ashtu, një veprim i tillë bie ndesh edhe me nenin 28 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili obligon Autoritetin Kontraktues që specifikimet teknike të jenë të qarta, të sakta dhe të mjaftueshme për përgatitjen e ofertave, si dhe me nenin 59 të LPP-së, sipas të cilit vlerësimi i ofertave duhet të bëhet vetëm mbi bazën e kërkesave dhe kritereve të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, e jo mbi kritere apo interpretime të reja të prezantuara pas dorëzimit të ofertave. Për rrjedhojë, eliminimi i Operatorit Ekonomik PRISIG SH.A. është rezultat i një kriteri që nuk ka qenë pjesë e dokumentacionit të tenderit dhe, si i tillë, është i kundërligjshëm dhe cenon parimet themelore të prokurimit publik.

Në përputhje me Nenin 28 të Ligjit për Prokurim Publik, Autoriteti Kontraktues ka obligim që specifikimet teknike dhe përshkrimi i kërkesave të tenderit të jenë të qarta, të

sakta dhe pa paqartësi, në mënyrë që operatorët ekonomikë të mund të përgatisin oferta në mënyrë të barabartë dhe transparente. Megjithatë, Komisioni i Vlerësimit ka aplikuar një interpretim të mëvonshëm dhe të ndryshëm nga dokumentacioni i tenderit, duke e riklasifikuar automjetin KIA 1.46 Ton në Grupin Tarifor II dhe duke e përdorur këtë si bazë për eliminim, gjë që përbën devijim nga kushtet e përcaktuara fillimisht nga Autoriteti Kontraktues.

Një qasje e tillë është në kundërshtim me:

Nenin 40.2 të Rregullores së Prokurimit Publik, i cili përcakton se vlerësimi i ofertave duhet të bëhet ekskluzivisht në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit, pa ndryshuar apo interpretuar në mënyrë që ndryshon kuptimin e tyre pas hapjes së ofertave;

Nenin 40.6 të Rregullores së Prokurimit Publik, i cili ndalon çdo devijim nga kriteret e përcaktuara dhe obligon autoritetin kontraktues që të trajtojë ofertat në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë, duke mos aplikuar standarde të ndryshme gjatë procesit të vlerësimit;

Nenin 40.12 të Rregullores së Prokurimit Publik, i cili kërkon që çdo sqarim apo interpretim i ofertave të mos çojë në ndryshim material të ofertës apo në krijimin e kriterëve të reja që nuk kanë qenë pjesë e dokumentacionit të tenderit.

Në këtë rast, riklasifikimi i automjetit dhe përdorimi i një grupi tarifor të ndryshëm nga ai i paraqitur në ofertë përbën në fakt krijim të një kriteri të ri pas dorëzimit të ofertave, duke e vendosur operatorin ekonomik në pozitë të pafavorshme dhe duke cenuar parimet bazë të transparencës, barazisë dhe sigurisë juridike në prokurim publik.

Ndërkohë, nga vet natyra e klasifikimit të sigurimeve dhe nga përmbajtja e grupimeve tarifore, rezulton se Autoriteti Kontraktues ka pasur njohuri dhe informacione për kategorizimin real të automjeteve sipas tonazhit, përfshirë edhe faktin që automjeti në fjalë bie në kategorinë e automjeteve me tonazh (1.46 Ton) dhe jo në një klasifikim të bazuar vetëm në cmł.

Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, në tabelën e çmimeve është kërkuar deklarimi i çmimit mbi bazën e cmł, duke krijuar një mospërputhje thelbësore ndërmjet:

mënyrës së kërkuar të ofertimit (cmł), dhe  
mënyrës së mëvonshme të vlerësimit (tonazh / grup tarifor).

Kjo mospërputhje ka krijuar një situatë të gabuar dhe na ka çuar në interpretim të arsyeshëm në përputhje me dokumentin e tenderit, duke u bazuar ekskluzivisht në të dhënat e paraqitura nga vetë Autoriteti Kontraktues.

Si rrjedhojë, jemi vënë në lajthitje dhe jemi udhëhequr nga një informacion i paplotë dhe jo i harmonizuar në mënyrë të saktë brenda dosjes së tenderit, gjë që bie ndesh me parimin e transparencës dhe qartësisë së kërkesave në prokurim publik.

Për më tepër, çdo parregullsi eventuale në mënyrën e klasifikimit tarifor të automjeteve bie në përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktues në fazën e hartimit të dosjes së tenderit, dhe nuk mund të përdoret si arsye për eliminim të ofertës kur operatori ekonomik ka vepruar në përputhje të plotë me të dhënat e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit.

Nëse Autoriteti Kontraktues konsideron se automjeti është klasifikuar gabimisht në Listën e Çmimeve, atëherë ky është një lëshim i bërë nga vetë Autoriteti Kontraktues.

Sipas parimeve të prokurimit publik dhe praktikës së vazhdueshme të OSHP-së, Autoriteti Kontraktues nuk mund të përfitojë nga gabimet e veta procedurale duke eliminuar operatorët ekonomikë që kanë ofertuar pikërisht sipas dokumentacionit të publikuar.

Përgjegjësia për përmbajtjen e dokumentacionit bie mbi Autoritetin Kontraktues dhe jo mbi operatorin ekonomik.

Gjithashtu pas shqyrtimit të dokumentacionit të OE Sava, edhe pse në kërkesë të autoritetit kontraktues ka qenë që OE duhet të dorëzojë “Kopjen e Licences nga BQK, për kryerjen e shërbimeve të kërkuara”, kemi parë që OE ka dorëzuar Licencën në emër të OE Illyria dhe jo në emër të OE Sava. Poashtu nuk është dorëzuar Aneksi 1 – Specifikacionet teknike, I nënshkruar dhe I vulosur që e bënë OE formalisht edhe obligues/pajtuës për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në këtë aneks.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe nenit 40.2, 40.6, 40.12, të RRPP Nr.001/2022, nuk është bërë në harmoni me nenin 28 të LPP-së dhe nenit 19.1, 19.4, 19.11 të RR/PPP Nr.001/2022 kurse njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, ndërsa paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që “Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”,

Po ashtu, autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Përfundimisht, Autoriteti kontraktues, ka bërë dhënie të gabuar, mosdeklarim të

informatave të sakta apo ndoshta edhe fshehje të informacionit, duke na vënë në lajthitje, më saktësisht të lista e çmimeve tek automjeti Kamionet Kia K 2500 D/C e ka vendosur mjetin në fjalë me kubik (cm<sup>3</sup>), me çmim për njësi me tvsh 268.96€, dhe ka kërkuar që Operatorët Ekonomik të përmbahet kësaj liste sipas këtyre çmimeve, mirëpo pikërisht tek arsyetimi i dhënë operatoreve ekonomik për diskualifikim, A.K. thotë se kjo Kamionet hyn në grupin tarifor Ton Automjet, me çmim 240.72€, duke ndryshuar plotësisht informacionin që e ka dhënë vet dhe ka që kërkuar të gjithëve ti përmbahen atij. Ky veprim paraqet ndryshim të njëanshëm të kritereve të vlerësimit pas hapjes së ofertave, dhe krijon një situatë ku Operatorët Ekonomikë janë vlerësuar mbi bazën e një informacioni që nuk ka qenë i përcaktuar në Dosjen e Tenderit, por është përdorur vetëm në fazën e vlerësimit.

Një qasje e tillë cenon rëndë parimet themelore të prokurimit publik, në veçanti parimin e transparencës, trajtimit të barabartë dhe sigurisë juridike, pasi Operatorët Ekonomikë nuk mund të penalizohen për mosrespektimin e një klasifikimi i cili nuk ka qenë i shprehur në dokumentacionin e tenderit.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga AK që të merr:

## **VENDIM**

**APROVOHET** ankesa e **OE “KOMPANIA E SIGURIMEVE PRISIG SH.A”** si e bazuar,

**ANULOHET**, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM**,

**DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

### **Deme ne emer te fitimit te humbur dhe demtim i reputacionit ne tregun e sigurimeve**

#### **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*